



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja **urgjente** e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.09.2025**, me fillim në orën **11:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm ishin 16.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje urgjente, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite me një pikë:

R E N D D I T E

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2026.**

Kryesuesi: E vendosim në votim këtë pikë! Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht votohet pika e rendit të ditës.

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, të nderuar asambleistë. Kam kënaqësinë që para juve të lexoj buxhetin e përgatitur për vitin 2026-2028. Në bazë të qarkores së parë buxhetore, të cilën e kemi diskutuar në kuvend dhe në dëgjime buxhetore, ndërkohë në mes të korrikut ka ardhur edhe qarkorja e dytë buxhetore, e cila nuk ka asnjë ndryshim, me përjashtim 44.000€ që janë tërhequr nga pozicioni i pagave dhe kanë kaluar në investime kapitale. Në bazë të qarkores së dytë buxhetore më lejoni që t’ju jap të dhënat përfundimtare - preleminare të buxhetit të Komunës së Rahovecit, 2026-2028. Buxheti në pozicionin e pagave është 12.454.000, mallra dhe shërbime 2.769.000, komunal 390.000, subvencione 1.000.000€ dhe investime kapitale 4.942.000, që e përbëjnë një buxhet total prej 21.547.734€. Te kategoria e subvencioneve i kemi vetëm 1.000.000€ dhe këto ndahen për Drejtorinë e Kulturës, zyrën e kryetarit, në shëndetësi dhe pjesa më e madhe shkon në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë, rreth 500.000€. Në bazë të dëgjimeve buxhetore dhe duke marrë parasysh kërkesat e qytetarëve, e kemi përgatitur edhe listën e projekteve kapitale, një dokument që e keni para vetes. Në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa, e kam vërejtur që të gjitha kërkesat e paraqitura nga qytetarët janë të mbuluara në listën e projekteve kapitale. Kësaj radhe i kemi 8 projekte të reja kapitale, të cilat kanë qenë në plan të prokurimit, mirëpo, thesari i tërhequr për kontratën kolektive dhe realisht edhe këto projekte trajtohen si projekte të reja. Të nderuar asambleistë, kërkoj nga ju që të votohet kjo pikë e rendit të ditës, sepse po e votojmë buxhetin për vitin 2026, i cili është i dedikuar për qytetarët e komunës së Rahovecit.

Leonard Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media, qytetarë... Këtë dokument, i cili është shumë i rëndësishëm për komunën tonë, e kam analizuar aq sa kam pasur mundësi edhe pse nuk ka pasur diçka aq të thellë për ta analizuar. Prej 48 projekteve, veç 6 jashtë projekte të reja. Ne e dimë gjendjen e komunës tonë dhe e dimë që është e varfër me buxhet dhe që përmbaruesit janë hedhur mbi komunë, si dhe nuk ka mundësi për investime të shumta. Kush është përgjegjës për këtë? Normal duhet, ata që e kanë udhëhequr komunën. Arsyet janë munduar t’i japin, mirëpo sido që të jetë, ata e kanë bërë që të jetë në këtë gjendje. Sa i përket buxhetit, jam ndalur te Malësia e Vogël. Ka 4 vite që kam kërkuar rrethoja të oborrit të shkollës, për shkak të rrezikut që vjen nga qentë endacakë për nxënës në mëngjes. Kjo nuk ka ndodhur, ndonëse ka qenë një projekt dhe ndoshta rrethojat kanë shkuar në shkollë të tjera. Tani e pashë që Malësia e Vogël po përmendet në dy vende. Magenëse është projekt që përfshihen disa fshatra, shihet që janë të ndara 100.000€ te pika e 7, ndërsa te pika 20 janë 180.000€. Nëse e shikojmë në proporcion se sa fshatra marrin pjesë, i bie që për vitin 2026 afër 30.000€ do

të investohen në Malësi të Vogël. Vazhdimisht e kam cekur që në zyrën e kryetarit ka shpenzime shumë të mëdha, e cila për vitin 2026 ka shpenzime 55.000€, një zyre me 20m² dhe me një staf përreth, ndërsa Malësia e Vogël me mbi 3000 banorë, investime afër 30.000€. Këtë buxhet, besoj që e ka pa edhe drejtoresha Sarandë Sallteku, meqenëse vjen nga Malësia e Vogël, ku unë kërkoj edhe nga kjo që të paktën të bëjë tryzni, që së paku të sigurohet oborri i shkollës, sepse kjo është gjëja më elementare në Malësi të Vogël. Besoj që kryetari do të ndërmerr diçka rreth kësaj rrethoje. Uuk kam çka them tjetër rreth buxhetit, sepse veç 6 projekte janë të reja, aq sa ka pasur mundësi. Dua të ndërlidhem pak me pozitën dhe opozitën. Opozita nuk ka ardhur sot që ta votojë buxhetin, meqenëse 3 vjet ka qenë prezente dhe e kanë kaluar buxhetit, ndërsa sot nuk vjen dhe kjo ndoshta për mua mund të thonë që “ky qenka interesgj”, por unë besoj që interesin më të madh dhe më të shkurtër e kanë ata që sot nuk kanë ardhur. Ata që nuk kanë ardhur sot, e kanë interesin e shkurtër që janë në garë dhe mendojnë t’i fitojnë disa vota. Ne e kemi potencuar vazhdimisht që buxheti nuk na ka pëlqyer, nuk e kemi përkrahur, por në kuvend kemi ardhur. Unë dua t’i tregoj qytetarëve që nuk kam kurrfarë interesi që kam ardhur këtu, por interes kanë ata që sot mundojnë në seancë. Ju falënderoj dhe shpresoj që ky buxhet të kalojë. I kërkoj ndryshimet që i përmenda, por nëse nuk ndodhin, vota ime do të jetë kundër dhe tutje ju si ta vlerësoni!

Hasan Përboqi: Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë, drejtorë të drejtorive, media, qytetarë. Në emër të 15 këshilltarëve të AAK-së, ashtu siç jemi deklaruar në seancën e rregullt, njëjtë deklarohemi edhe sot, që jemi “për” miratimin e buxhetit. Buxheti është dokumenti më i rëndësishëm financiar brenda një viti për Komunën e Rahovecit dhe përfaqësimin e qytetarëve kemi mundësi ta vendosim në buxhet, duke e votuar dhe duke e dërguar te qytetarët. Si grup, mendojmë që duke u bazuar në situatën momentale, ky buxhet është buxheti më i mirë i mundshëm që ka mundur të planifikohet. Grupi i Aleancës asnjëherë nuk i ka ikur ballafaqimit në kuvendin komunal dhe sot është keq që disa nga partitë opozitare po mungojnë. Përfaqësimi i drejtë i qytetarëve bëhet në kuvend dhe jo me deklarata në rrjete sociale.

Afrim Limani: Leonard, faleminderit shumë për pyetjet! Po tentoj ta jap një përgjigje, e cila deri më tani ndoshta edhe ka munguar, sepse për shkak të modestisë e kam anashkaluar. Po e shoh që në lidhje me “projektet në vazhdim” po shkruajnë mediat dhe opozita nga më të ndryshmet. E para, komuna e Rahovecit aktualisht këtë buxhet që e ka prej 4.9 milionë dhe detyrimisht duhet të bëjmë “projekte në vazhdim”, jo vetëm ne, por secila qeveri që vjen këtë e bën. Për shembull, ndërtimi i sheshit – kontrata 5 milionë! Tani, paramendojeni nëse 5 milionë do t’i vendoseshin në shesh, çfarë të bëjmë me projektet e tjera? Mos të punojmë asgjë? Ne gjithashtu kemi kontrata që vazhdimisht janë në proces dhe që e ruajnë kodin ekonomik. Po t’i përmendi tri prej tyre: Ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i kanalizimeve dhe ndërtimi i rrugëve fushore. Të gjitha janë kontrata që vazhdimisht do të jenë “në vazhdim”, sepse çdo herë do të ketë rrugë, kanalizime e kërkesa të reja. Shembull tjetër: Ndërtimi i kanalit të kullimit Hoçë e Madhe – Krushë e Madhe, me vlerë 2 milionë, në këtë rast, ne detyrohemi ta kontraktojmë këtë vlerë dhe ta buxhetojmë brenda mundësive buxhetore, sepse buxheti i komunës është i limituar. Paramendojeni, pozicioni i pagave është 10.7 milionë euro, ndërsa investimet kapitale janë rreth 5 milionë. Rrethoja e shkollës në Radostë, ka qenë pjesë e projektit në këtë vit, mirëpo fatkeqësisht lënda ka shkuar në OSHP, ndërkohë thesari i ka tërhequr të gjitha paratë dhe ky projekt për Malësi të Vogël mbetet për vitin e ardhshëm dhe është i planifikuar. Hasan, faleminderit shumë për fjalët e mira, që faktikisht ashtu janë.

Kryetari: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, monitorues, përfaqësues të LMT-së, KFOR-it, OSBE-së. E kemi ftuar këtë seancë urgjente, sepse afati ligjor për miratimin e buxhetit është më 30 shtator. Në seancën e kaluar të rregullt, e kemi potencuar dhe po e ritheksojmë faktin që, miratimi i buxhetit është vepra më e rëndësishme për të mirën e qytetarëve. Ky buxhet është planifikuar në bazë të standarteve dhe kërkesave ligjore dhe në bashkëpunim të plotë me Ministrinë e Financave. Buxheti është i qytetarëve të komunës së Rahovecit, nuk është as i kryetarit e as i drejtorit të Financave. Ky vit nuk ka qenë i lehtë, për shkak të procedurave përmbartimore për shkak të kontratës kolektive. Përgjigja ime për Leonardin, të cilin e çmoj shumë, njëjtë sikurse secilin prej jush

që jeni anëtarë të kuvendit, është që kemi kontratë për rrethoja dhe është e domosdoshme që këto rrethoja të realizohen sa më shpejt në shkollën e mesme të ulët "Skender Kastrati" në Malësi të Vogël. Dëshira jonë ka qenë që sa më shumë të ketë projekte të reja, mirëpo, rrethanat ligjore dhe buxhetore për shkak të përballjeve me thesarit e kanë bërë që të ketë edhe vonesa të tilla të projekteve. Në Malësi të Vogël, gjithashtu do të bëhet edhe një park me gjelbërim, rrugët do të kubëzohen, sepse kemi kontratë dhe besoj që, si në çdo lokalitet edhe te ju do të ketë veprime. Ju që jeni këtu, besoj jeni njerëzit më të mirë që ka komuna jonë, sepse veproni qoftë "për", kundër apo abstenim. Nuk e kuptoj dot mosprezencën e atyre që vazhdojnë të jenë të zgjedhur. Bojkoti i kuvendit komunal, në një situatë që rrjedhimisht i bie që qytetarët të penalizohen, me mospjesëmarrje në seancë është e paprecedent. Jam i bindur që ata do ta marrin përgjigjen e merituar, sepse ia kanë mundësuar vetes pozicionin, që mos të ketë të drejtë të kërkojnë asgjë. Nuk ka lidhje, pozita apo opozita, ne jemi njerëz të zgjedhur dhe vazhdojmë të cilësohemi të njëjtë derisa të përmbillet procesi. Prandaj e çmoj prezencën e secilit prej jush, duke mos harruar prezencën edhe të Leonard Morinës, i cili e ka bërë veprën më të mirë të mundshme dhe i ka dhënë përgjigje situatës konkrete ku jemi. Buxheti kalon, por edhe nuk është me rëndësi a kalon, por ne duhet t'i përgjigjemi ligjit. Në momentin kur është tërhequr pika nga rendi i ditës, kam marrë rekomandim prej Ministrisë së Financave: "Ju lutem kryetar i Komunës së Rahovecit, thirrë seancën dhe hedhe në votim buxhetin, nuk ka rëndësi a votohet kundër apo për". Sipas ligjit, këtë fakt sot po e dëshmojmë, sepse deri më 30 shtator është afati i fundit i votimit të buxhetit. Akti më i ulët i mundshëm, në kundërshtim me interesin publik është bojkoti, ndërsa në anën tjetër për 4 vjet rresht marrim paga dinjitoze. E vlerësoj edhe një herë pozicionin e secilit prej jush. Ftesa për bojkot është "nonsens" dhe besoj që ne do të shihemi nesër e pasnesër me ata që e kanë bojkotuar. Është koha për votim dhe si të doni vlerësoni!

Leonard Morina: Te drejtori i Financave: drejtor, sa e di unë 30% i projekteve duhet të jetë me projekte të reja. Ti e the që sheshi është 5 milionë dhe nuk ka "qare" pa qenë në vazhdim, sepse nuk kemi mjete. Janë disa rrugë fushore që mund të jenë kontrata pak më të shkurtëra. Nuk e di arsye pse zgjatet kështu "vazhdim - vazhdim". Gjatë këtyre viteve jam munduar të jem i arsyeshëm në kërkesat e mia, njëjtë ke qenë edhe ti në përgjigjet e tua. Nëse ky buxhet nuk kalon, unë e di që nuk dëmtohet Smajl Latifi, por vetëm qytetari i komunës sonë. A e kemi pasur lehtë këto 4 vite? Jo! A jemi ballafaquar me fyerje e ofendime, por jo me inate personale? Po! Secili ndonjëherë jemi ballafaquar, dikush me dashje e dikush pa dashje. Prej Rasim Fazliut, Hasan Përboqit, Shqipe Kryeziut, Leonard Morinës, Faton Ramadanit e shumë të tjerëve, pra, nuk kemi mundur që të ofendohemi këtu, e më pas të shkojmë në shkollë që t'u themi nxënësve se si të sillet ata. Kemi qenë të rezervuar në sjellje, sepse jemi modelë nëpër shkolla.

Afrim Limani: Leonard, ta shpjegoja më herët dhe e mora shembull sheshin, kontrata e të cilit e kap vlerën 5 milionë € sa krejt buxheti jonë për investime kapitale. Ka kontrata të tjera që e kanë vlerën, 1 apo 2 milionë. Bindu në një gjë që, në mënyrë shumë detale e kemi analizuar dhe planifikuar këtë buxhet, gjithmonë brenda mundësive buxhetore që i kemi pasur. Fatbardhësisht, si komunë kemi arritur të përfitojmë shumë donacione, si rezultat i asaj që jemi komunë me performancë të mirë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Të nderuar të pranishëm, në sallë jemi 16 anëtarë të kuvendit. E vendosim në votim pikën: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2026! Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota "për", 1 votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet buxheti për vitin 2026. Duke ju falënderuar për prezencën tuaj, e quaj të mbyllur këtë mbledhje urgjente.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

